

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza në çështjen penale kundër të akuzuarit S.(E.) L. me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.501/19 të dt.27.01.2019 pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Rexhep Maqedonci, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.H.P. nga P., me datë 28.01.2019 mori, publikisht në prezencë të palëve shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

S.L. nga i ati E. dhe nëna N., e gjinisë N., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i martuar-baba i 3 fëmijëve, Shqiptar- Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës,gjendet në paraburgim nga data 27.01.2019 nga ora 03:15 e tutje.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 27.01.2019, rreth orës 01:00, në dhomën e tij të gjumit në shtëpinë e tij e cila gjendet në rrugën “...”, pnr., në P. i pandehuri S.L. ka rënë ndesh me dispozitën ligjore të nenit 2 paragrafi 1 nënpar.1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.4 të Ligjit nr.03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, ashtu që pas mosmarrëveshjeve lidhur me të kaluarën e bashkëshortes së tij, tani e dëmtuara M.L. me dashje ka përdorur forcën fizike ndaj saj ashtu që të njejtën e kishte goditur me shuplakë në fytyrë dhe e kishte gjuajtur me një këpucë me të cilën e kishte goditur në syrin e djathtë me ç’rast sipas raporteve mjekësore sipas QKMF-së Podujevë të datës 27.01.2019 e dëmtuara ka pësuar dëmtime trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 73, 83 dhe nenit 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 367, 369, 370, 450, 453, 463 të KPPRK-së, i shqipton këtë:

D Ë N I M M E B U R G

Të pandehurin S. L. e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh, të cilin dënim do ta vuaj, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 83 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.01.2019 e tutje.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 Euro (për ekspertizën Mjeko-Ligjore), kurse në emër të shpenzimeve-paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Detyrohet i pandehuri që në emër të kompenzimit të viktimave të paguaj shumën prej 30 Euro brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara M.L. nga P., rr:”...”, pnr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Pas shpalljes së aktgjykimit gjykata duke u bazuar në nenin 367 par.1 nënpar.1.1 lidhur me par.5 dhe par.7 të KPRK-së, të pandehurit i ka caktuar masën e paraburgimit deri në plotëfuqishmërinë e aktgjykimit, i cili paraburgim nuk mund të zgjasë më shumë se dënimi i shqiptuar në aktgjykim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën, PP/II.nr.501/19 të dt.27.01.2019 me kërkesën për caktimin e paraburgimit S.(E.)L. me vendbanim në P., rr:”...”, pnr., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 28.01.2019 gjatë së cilës u dëgjuan përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Prishtinë Rexhep Maqedonci, i akuzuari S.L. dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av.H.P. nga P.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë, jam penduar rëndë që më ka ndodhur ky rast dhe ju betohem në zot që ska me ndodhur kurrë për jetë, që 11 vite jam martuar, kurrë skemi pasur probleme me bashkëshorten time, kemi qenë shembull në atë familje por ka qenë moment i qastit, jam kujdestar i vetëm i familjes, përkujdesem për fëmijët, bashkëshorten dhe prindërit e mijë dhe lus gjykatën që të mos më caktoj masën e paraburgimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.H.P. nga P. lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: Pas bisedës së të akuzuarit i njëjti deklaroi edhe para gjykatës se ka pasur mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij, gjatë përcaktimit të dënimit dhe kërkesës për caktimin e paraburgimit sa i përket dënimit kisha lutur gjykatën që të ketë për bazë si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, është baba i 3 fëmijëve dhe në pritje të fëmijut të 4-ët, nuk ka kush të kujdeset për ta dhe mungesa e tij do të ndihet te fëmijët dhe ti shqiptoj një dënim me kusht i cili sigurisht do të arrijte efektin e tij në të ardhmen.Sa i përket caktimit të masës duke marrë për bazë se i njëjti pranoj fajësinë nuk ekzistojnë rrethana tjera se po te gjendet i njëjti në liri do të kryente vepër penale andaj i propozoj gjykatës që sa i përket masës për caktimin e paraburgimit të njëjtën ta refuzoj.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.H.P., pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar edhe nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se e pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pranimi i fajit u bë me vullnetin e tij të plotë, pa kurrfarë presioni dhe konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, andaj i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë ndërsa sa i përket kërkesës për caktimin e paraburgimit le të vendos gjykata.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pendimin e tij pas kryerjes së veprës penale, këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si rrethana rënduese gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale e që ka të bëjë me përdorimin e dhunës fizike ndaj bashkëshortes-viktimës së ndjeshme dhe dhunën psikike për një kohë të gjatë, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerave të mbrojtura siq është jeta dhe shëndeti trupor i njeriut. Andaj, gjykata të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 83 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u morr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.30/2019 me dt.28.01.2019

Sekretare Juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.